

VENDIM
Nr.355, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.551, DATË 7.11.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRUPIMIN E NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, E PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË
PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshar, dhe të neneve 32 e 54 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, lidhja nr.1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 2, lidhja nr.2 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në pikën 3, lidhja nr.3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Në pikën 4, vlera “...9 306 (nëntë mijë e treqind e gjashtë) lekë...” zëvendësohet me vlerën “...10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë...”.

d) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1 Paga e grupit (kolona 2) – Diploma e shkollës së lartë për nëpunësit, që kanë kryer vite studimi në shkollën e lartë, por që nuk e kanë mbrojtur diplomën, të jetë 9 000 (nëntë mijë) lekë.”.

dh) Pika 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Nivelet e pagave për këto funksione të jenë:

a) Për Bashkinë e Tiranës:

- Kryetari 113 456 – 162 855 lekë;

- Nënkyetari 75 456 – 127 027 lekë.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore me më tepër se 50 000 banorë:

- Kryetari 53 916 – 108 570 lekë;

- Nënkyetari 22 800 – 81 428 lekë.

c) Për njësitë e qeverisjes vendore me 20 001 deri në 50 000 banorë:

- Kryetari 36 892 – 86 856 lekë;

- Nënkyetari 21 714 – 70 571 lekë.

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore me 5 001 deri në 20 000 banorë:

- Kryetari 22 800 – 70 571 lekë;

- Nënkyetari 18 457 – 59 714 lekë.

d) Për njësitë e qeverisjes vendore, me më pak se 5 000 banorë:

- Kryetari 18 457 – 43 428 lekë;

- Nënkyetari 17 371 – 32 571 lekë.

dh) Për këshillin e qarkut:

- Kryetari 75 456 – 119 427 lekë;

- Nënkyetari 43 971 – 81 428 lekë.

e) Për funksionin e sekretarit:

- Sekretari i kryetarit të Bashkisë së Tiranës – kategoria IV-a,

(lidhja nr.1);

Sekretari i kryetarit të bashkive të tjera - kategoria IV-b,
(lidhja nr.2;

- Sekretari i kryetarit të këshillit të qarkut të Tiranës – kategoria IV-b,
(lidhja nr.3).”.

ë) Pika 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

“15. Paga e punonjësve, që kanë funksione në shërbimin civil, por që nuk kanë arsimin e lartë, caktohen nga këshilli përkatës, në kufirin maksimal deri në 27 143 (njëzet e shtatë mijë e njëqind e dyzet e tre) lekë.”.

f) Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

“16. Paga e punonjësve të tjerë (që nuk janë nëpunës civilë) të njësive të qeverisjes vendore caktohet nga këshilli përkatës, në kufirin maksimal deri në 21 714 (njëzet e një mijë e shtatëqind e katërmëdhjetë) lekë.”.

2. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE (LEKË)			
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	10.050	2%	0	Nga 54.068 deri 108.570
II	II-a	10.050	2%	0	Nga 54.068 deri 97.713
	II-b	10.050	2%	0	Nga 44.145 deri 80.342
III	III-a	10.050	2%	0	Nga 14.114 deri 59.714
	III-b	10.050	2%	0	Nga 13.028 deri 43.428
IV	IV-a	10.050	2%	0	Nga 7.600 deri 32.571
	IV-b	10.050	2%	0	Nga 7.600 deri 21.714

Lidhja nr.2

NIVELET I PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË E TJERA, NJËSITË BASHKIAKE TË TIRANËS DHE NËPUNËSIT E KOMUNAVE

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE (LEKË)						
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT			
					Njësi të qeverisjes vendore me mbi 50000	Njësi të qeverisjes vendore me 20001-	Njësi të qeverisjes vendore me 5001-20000	Njësi të qeverisjes vendore me më pak se

					banorë	50000 banorë	banorë	5000 banorë
	1	2	3	4	5	6	7	8
		Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion	Shtesa për pozicion
I	I-b	10.050	2%	0	Nga 13.028 deri 44.514	Nga 11.943 deri 33.657	Nga 8.686 deri 22.800	Nga 6.514 deri 18.457
II	II-a	-	-	-	-	-	-	-
	II-b	10.050	2%	0	Nga 9.771 deri 33.657	Nga 9.771 deri 28.228	Nga 6.514 deri 21.714	-
III	III-a	-	-	-	-	-	-	-
	III-b	10.050	2%	0	Nga 9.771 deri 28.228	Nga 9.771 deri 22.800	Nga 6.514 deri 17.371	Nga 5.429 deri 14.114
IV	IV-a	10.050	2%	0	Nga 3.257 deri 17.371	Nga 3.257 deri 17.371	Nga 2.171 deri 15.200	Nga 2.171 deri 11.943
	IV-b	10.050	2%	0	Nga 3.257 deri 14.114	Nga 3.257 deri 11.943	-	-

Shënim. Këshilli i bashkisë dhe i komunës në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion, sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të regjistrit të gjendjes civile në fillim të vitit kalendarik.

Lidhja nr.3

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

KLASA	KATEGORITË	PAGA MUJORE (LEKË)			
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	
			Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim
I	I-b	10.050	2%	0	Nga 27.143 deri 55.371
II	II-a	-	-	-	-
	II-b	10.050	2%	0	Nga 11.943 deri 39.085
III	III-a	-	-	-	-
	III-b	10.050	2%	0	Nga 9.771 deri 28.228
IV	IV-a	10.050	2%	0	Nga 3.257 deri

					19.543
	IV-b	10.050	2%	0	Nga 3.257 deri 14.114